

## PËRMBLEDHJE E MINUTAVE TË TAKIMIT

### KËSHILLI KOMBËTAR PËR EKONOMI DHE INVESTIME (KKEI)

#### TAKIM I RREGULLT, III

Prishtinë, 8 tetor 2024, 10:00 – 12:30

Takimi u kryesua nga Kryeministri Albin Kurti, ndërsa u moderua nga Artan Mehmeti, Udhëheqës i Sekretariatit të Këshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime. Në takim morën pjesë 22 anëtarë dhe rreth 40 vëzhgues. Pjesëmarrës ishin përfaqësues të shoqatave vendore të biznesit, të organizatave të huaja, dhe institucioneve shtetërore në Kosovë.

#### Fjalët hyrëse

**Artan Mehmeti, Sekretariati, KKEI**, në fjalën e tij hyrëse falenderoi Kryeministrin Kurti, anëtarët e kabinetit qeveritar, stafin, institucionet vendore, përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare, odat dhe shoqatat përfaqësuese të bizneseve vendore për pjesëmarrje në takimin e KKEI, dhe për bashkëpunimin e përgjithshëm për dialog publiko-privat. Ai tutje theksoi qëllimin e takimit, që shërben për të përafuar institucionet publike dhe sektorin privat, e që në këtë mënyrë të mundësojë fasilimin e reformave që kanë të bëjnë me klimën investive dhe mjedisin e të bërit biznes në Kosovë. Udhëheqësi i Sekretariatit shtoi se ky takim mundëson edhe diagnostikimin më të mirë të rekomandimeve, hartimin e politikave dhe reformave. Po ashtu njoftoi pjesëmarrësit për ndryshim në agjende e që pas prezantimit të Agjencisë për Investime dhe Eksport do të prezantohet edhe themelimi i Agjencisë për Inovacion për Perkraheje e Ndermarrjeve në Kosovë.

**Kryeministri Albin Kurti, Kryesues, KKEI**, theksoi se Kosova është një vend tërheqës për investime me një popullsi të re. Vendi ka potencial të bëhet një qendër rajonale për investime dhe transfer të proceseve të bizneseve (*business process outsourcing*). Disa nga faktorë mbështetës të këtij potenciali janë:

- Stabiliteti institucional, fuqizimi i demokracisë dhe sundimi i ligjit;
- Afërsia me tregjet e Evropës Perëndimore;
- Rritja ekonomike mesatare prej 6.2% gjatë dy viteve të fundit e cila dëshmon një trend pozitiv në zhvillimin ekonomik;
- Zhvillimi i projekteve infrastrukturore për një ekonomi të qëndrueshme;

- Zhvillimi i grupeve sektoriale si shërbimet e teknologjisë informative, prodhimi, dhe bujqësia, me ririnë e kualifikuar si burim të rëndësishëm, së bashku me vullnetin e mirë të mërgatës sonë.

Kryeministri theksoi se qeveria aktuale është e para që përfundon një mandat të plotë, duke reflektuar stabilitetin dhe besimin në proceset demokratike.

Ai gjithashtu theksoi politikën e *friendly shoring*, që ofron mundësi për prodhuesit të rialokohen në rajonin tonë, me qëllim të që largohen prej zonave të ndryshme të konflikteve apo të tensioneve duke i dhënë Kosovës një avantazh në zhvillimin global.

Një fokus thelbësor është përmirësimi i arsimit dhe trajnimit profesional për të përgatitur punëtorë të kualifikuar për sektorin privat. Tani ka 23 shkolla në 14 komuna me 1600 nxënës. Qeveria ka krijuar 75,000 vende të reja pune, duke bërë kështu që të mos protestohet më me parulla duke kërkuar vende pune.

Përmes dialogut publiko-privat janë identifikuar mundësi për avancimin e sektorit privat dhe për tërheqjen e investimeve të huaja. Kjo platformë ndihmon aktorët privatë të identifikojnë sfidat që hasin, dhe institucionet publike duhet të vlerësojnë dhe zgjidhin këto çështje. Megjithatë, Sekretariati duhet të vlerësojë dhe validojë çështjet në përputhje me metodologjinë e punës. Duhet të përcaktohen proceset dhe metodologjia për zgjidhjen e tyre, të validohen çështjet me institucionet publike, duke përfshirë fazat dhe afatet për secilën kërkesë të paraqitur. Gjithashtu, Sekretariati duhet të mbikëqyrë efektet e ndërhyrjeve nga sektori publik dhe të përdorë indikatorë të rezultateve. Ftoj Sekretariatit të përgatisë këto hapa për mbledhjen e ardhshme, në mënyrë që të kemi një pasqyrë të qartë mbi kërkesat e sektorit privat dhe mundësitë e sektorit publik. Vetëm përmes partneritetit mes institucioneve qeveritare dhe sektorit privat, mund të përmirësojmë infrastrukturën dhe të sigurojmë që Kosova të mbetet një destinacion i qëndrueshëm për investime. Falenderoj për vëmendjen dhe mirëpres diskutimet për përmirësimet të mëtejshme.

**Artan Mehmeti, Sekretariati i KKEI**, informoi se pas takimit të Këshillit të muajit maj, janë organizuar disa diskutime mes sektorit privat dhe institucioneve publike në forume sektoriale për të identifikuar rekomandime dhe kërkesa për lehtësimin e të bërit biznesit. Disa nga këto çështje do t'i diskutojmë sot, veçanërisht çështjet për kyçjen në rrjet të energjisë elektrike dhe një propozim tjetër nga Oda Ekonomike Amerikane.

#### Stimujt tatimor për zhvillimin e fuqisë punëtore

Për stimujt tatimor, z. Mehmeti informoi se në takimin e kaluar është diskutuar për ndryshimet në ligjin që lehtëson njohjen e shpenzimeve për aftësimin profesional të stafit apo fuqisë punëtore. MPFT ka formuar një grup punues për të adresuar këtë çështje, i cili ka dërguar propozime në

Ministrinë e Financave për analizë të mëtutjeshme, me qëllim të përfshirjes në legjislacionin përkatës. Ndryshimet e propozuara përfshijnë lehtësira më të theksuara për edukim dhe aftësim profesional në sektorët strategjikë për shtetin, ndërsa incentiva të tjera për edukim dhe aftësim të përgjithshëm (siç është shkollimi master dhe doktoratë). Me rëndësi, është propozuar të largohet obligimi i punëmarrësit që të punoj tek punëdhënsi edhe dy vite pas marrjes së trajnimit, por që detajet si këto të lihen për t'u përcaktuar me kontratë të punës.

#### Humbjet natyrore, dëmtimi, shkatërrimi i produkteve për qëllime tatimore

Në lidhje me humbjet natyrore dhe dëmtimet e produkteve për qëllime tatimore, është diskutuar për një akt ligjor mbi humbjet e produkteve akcizore. Dogana ka filluar një draft, që pritet të finalizohet në muajin nëntor, e më pas do të merren inpute edhe nga palët e interesit. Ndërsa, për humbjet natyrore të produkteve ushqimore dhe produkteve tjera, nuk kemi ndonjë informatë nëse është ndërmarrë ndonjë masë. Besoj që për këtë nevojitet formimi i një grupi punues nga MFPT.

#### Anketat me bizneset

Si pjesë e metodologjisë sonë si Sekretariat, është edhe anketimi i bizneseve për të analizuar klimën e përgjithshme të biznesit, por dhe çështje specifike që ndikojnë në të bërit biznes në Kosovë.

Gjatë tetorit, janë zhvilluar anketa online me 267 biznese për të kuptuar përcëptimin e tyre mbi pengesat dhe pritshmëritë në të bërit biznes. Pritshmëritë për vitin 2024 tregojnë se 48.7% e bizneseve presin rritje, mesatarisht rreth 22.9%, ndërsa 18% presin rënie. Për eksportet, 65% e bizneseve që eksportojnë parashikojnë një rritje prej 34.2%. Në lidhje me numrin e punëtorëve, 14% presin rritje, ndërsa 14.2% parashikojnë rënie. Sa i përket investimeve, 34.5% e bizneseve parashikojnë rritje, ndërsa 52.8% nuk presin ndryshime. Anketa do të përsëritet të paktën një herë në vit për të monitoruar pritshmëritë e bizneseve.

#### Prezantimi i webfaqes së KKEI

Webfaqja e Këshillit, e titulluar [www.forumiks.org](http://www.forumiks.org), do të ndihmojë në organizimin e inputeve që pranojmë nga bizneset dhe organizimin e kalendarit të diskutimeve publiko-private, forumeve, e takimeve të Këshillit.

Element shumë i rëndësishëm i webfaqës është databaza e çështjeve, e cila ka grumbulluar rreth 200 çështje të ngritura nga sektori privat. Kjo do të ndihmojë në analizimin, raportimin, dhe monitorimin e çështjeve, duke pasur hapa konkret dhe afate për zgjidhjen e këtyre çështjeve. Për këtë, z. Mehmeti kërkoi bashkëpunim me insitucionet publike për adresimin e tyre, dhe u zotua se Sekretariati do të përpiqet t'i validojë çështjet me insitucionet përgjegjëse, e pastaj së bashku me to, të caktojë afate e hapa konkret për zgjidhjen e secilës çështje.

**Luan Dalipi, Shef i Stafit të Kryeministrit**, përgëzoi Sekretariatit për punën e bërë, shprehet se çështjet që ngrihen nga sektori privat do të duhej të validoheshin nga institucioni përkatës publik dhe të jepet një plan veprimi. Ai shprehu mirënjohje për qeverinë zviceriane që financon Sekretariatit, gjithashtu USAID, IFC, EBRD, diku mbi 15 shoqata biznesi e me institucione tjera me të cilat bashkëpunojnë. Vazhdoi duke treguar se për brendingun kanë mbetur vetëm edhe 3 për qind deri tek finalizimi. Tutje, z. Dalipi tregoi se Agjencia për Promovim të Eksportit, që do të themelohet në kuadër të ZKM, është në diskutim me Ministrinë e Financave për përcaktimin e buxhetit dhe strukturës organizative, që parashih të përfshijë 70 persona staf. Kjo strukturë përbëhet nga katër zyra kryesore: 1) zyra apo departamenti për investime, 2) zyra për eksport, 3) zyra e sektoreve dhe 4) zyra e shërbimit.

1) Zyra e Investimeve dhe 2) Zyra e Eksportit, janë paraparë të fokusohen fillimisht në vende si Zvicra dhe targetohen përmes Atasheve Komericalë, të specializuar në promovimin e investimeve dhe eksportit.

3) Zyra e sektoreve, që përfshin staf ekspertësh për 4 sektorë kryesorë në Kosovë: shërbime të teknologjisë informative, kontabilitet digjital, marketing digjital, zhvillim softuerësh, si dhe prodhim të lehtë. Ky sektor i prodhimit të lehtë ka potencial të madh, duke përfshirë kompani të identifikuar në 15 shtete, të cilat janë të gatshme për rilokim në Kosovë, falë avantazheve të near-shoring dhe friendly-shoring. Po ashtu, përfshihen bujqësia, përpunimi i ushqimit, energjia dhe minierat.

4) Zyra e Shërbimit, me ekspertë që do të fasilitojnë investimet e huaja dhe eksportin, duke mbuluar edhe pjesën e përkujdesjes pas investimit.

Kosova ka pozitë të favorshme në promovimin e investimeve falë demokracisë dhe indikatorëve të mjedisit të favorshëm. Agjencia pritet të funksionalizohet deri në tremujorin e parë të vitit të ardhshëm, dhe kërkohet angazhimi i të gjithëve për promovimin e konkursit të punës.

**Zef Dedaj, KIESA**, prezantoi fillimisht njoftoi për krijimin e dy agjencive: 1) Agjencioni për Inovacion dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve dhe 2) Agjencia për Inovacion dhe Zhvillim të Ndërmarrësisë.

Agjencioni për Inovacion dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve do të fokusohet në katër shtylla kryesore, në përputhje me Ligjin për Investime të Qëndrueshme dhe një rregullore që është në përfundim e sipër:

- Shtylla e parë - Zhvillimi i kapaciteteve prodhuese të destinuar për eksport, përmes grandskemave për rritje teknologjike, digjitalizim, certifikim, turizëm, produkte artizanale dhe

inovacion – me qëllim final që të rritet prodhimi dhe të përmirësohet bilanci tregtar si output final. Gjithashtu përfshihet organizimi i forumeve ekonomike të përbashkëta.

- Shtylla e dytë - Parqet industriale dhe teknologjike, që përfshijnë themelimin, financimin dhe promovimin e tyre, përfshirë qendrat e inovacionit dhe inkubatorët e biznesit.

- Shtylla e tretë - Inovacioni dhe Zhvillimi i Ndërmarrësisë, përmes themelimit të Fondit të Inovacionit, që do të mbështesë startup-et dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme me koncepte inovative, duke fuqizuar ekosistemin inovativ.

- Shtylla e katërt - Promovimi i turizmit, duke planifikuar investime kapitale në këtë sektor. Rregullorja përkatëse është 70% e përfunduar dhe synohet të ketë një strukturë me 40 të punësuar.

**Nora Hasani, OEGJK**, pyet z. Luan Dalipi dhe z. Zef Dedaj, për datat e funksionalizimit të këtyre dy agjencive dhe buxhetin e paraparë për to?

**Luan Dalipi, Shef i Stafit të Kryeministrit**, i përgjigjet znj. Hasani, se Ligji për Investime të Qëndrueshme u miratua nga Qeveria në janar 2023 dhe nga Parlamenti në tetor 2023. Ligji ishte dërguar në Gjykatën Kushtetuese nga një parti opozitare, dhe ai hyri në fuqi vetëm në shtator 2024. Ndërkohë, Qeveria ka shfrytëzuar kohën për të përgatitur planin e biznesit dhe janë në diskutime me Ministrinë e Financave për buxhetin final, i cili do të përcaktojë edhe numrin e stafit. Janë propozuar 70 persona për staf dhe 23 Atashe Komerciale për promovimin e investimeve. Kostot për atashetë do të jenë më të larta, pasi ata janë diplomat. Shpresojnë për kandidatë të mirëfilltë për këto pozita dhe presin bashkëpunimin dhe mbështetjen edhe nga shoqatat biznese. Tutje kërkoi edhe ndihmën e znj. Hasani për identifikimin e kandidatëve për Atashe Komercial në Gjermani, ku nevojitet numër më i madh i atashëve për shkak të madhësisë së tregut dhe faktorëve të tjerë.

**Zed Dedaj, KIESA**, iu përgjigj znj. Hasani duke shtuar se janë në koordinim të plotë me Zyrën e Kryeministrit në mënyrë që t'i funksionalizojnë të dy agjencitë së bashku me përfundimin e rregulloreve.

Çeshtja e buxhetit, projeksionet janë për rreth 20 milionë euro, ku 11 milionë janë të destinuara për përfundimin e infrastrukturës aktuale, përfshirë dy parqet industriale të themeluara së fundmi, dhe inkubatorin e biznesit. 7 milionë janë planifikuar për grandskema. Këtu do të kërkohet që të rritet buxheti për faktin se do të shtohet Fondi I Inovacionit, ndërsa pjesa tjetër mbeten mallra dhe shërbime ku KIESA e mbulon edhe programin EU single market me Bashkimin Evropian.

**Arian Zeka, Oda Ekonomike Amerikane (AmCham)**, shprehu mirënjohje për Sekretariatit, dhe mirënjohje për hyrjen në fuqi të Ligjit për Investime të Qëndrueshme, si ligj që adreson disa prej

rekomandimeve të komunitetit të biznesit përgjate viteve të kaluara për strukturimin e kapaciteteve për promovimin e investimeve dhe të eksporteve.

Z. Zeka vazhdoi duke parashtruar pyetje z. Dalipit se në cilat vende parashihen të emërohen Atashetë Tregtar/Komercial dhe një pyetje tjetër për z. Dedaj: A ka mundësi që rregulloren e cila pritet të aprovohet deri në fund të këtij muaji ta shohim edhe ne ashtu që të mund të komentojmë, pastaj rregullorja të jetë gjithëpërfshirëse edhe e cilesisë së lartë?

**Luan Dalipi, Shef i Stafit të Kryeministrit**, i përgjigjet z. Zeka duke thënë se, përderisa nuk finalizohet dhe miratohet buxheti, nuk mund të tregoj me siguri të plotë se cili vend do të jetë dhe sa shpejt do të funksionalizohen këto, sepse një faktor shumë i rëndësishëm është të kemi kandidatë të mirë. Do të mirëprisnim çfarëdo sugjerimi që mund të keni në këtë drejtim.

**Hartim Gashi, PePeKo**, shpreh mirënjohje për bashkëpunimin me KIESA-n dhe pyet për statusin e rezervimeve për pjesëmarrje në panairë në fillim të vitit 2025 dhe disa në fund të vitit 2024. Shpreh shqetësimin për panairin “Gulfood” që do të zhvillohet në Dubai për çka janë bërë shumë përpjekje nga KIESA që Kosova të përfshihet në listë për atë panair, kurse lista e pritjes është deri në pesë vjet. Shqetësohet mos Kosova e humb mundësinë që të merr pjesë në këtë panair për shkak të bartjes së përgjegjësive mes agjencioneve.

**Luan Dalipi, Shef i Stafit të Kryeministrit**, i përgjigjet z. Hartim Gashi duke shprehur gadishmërinë që të bashkëpunojnë që mos të ketë vakum për pjesëmarrje në këto panairë, por vë në pah se buxheti për vitin 2025 nuk është caktuar akoma. Ai vazhdon tutje se do të bashkëpunojnë edhe për panairë të tjera siç është ai “Swissbau” në Basel që do të mbahet në vitin 2026 dhe që planifikimet mund t’i fillojnë bashkarisht në janar 2025.

**Zed Dedaj, KIESA**, i përgjigjet z. Arian Zeka lidhur me datën e rregullorës se do të ndahet edhe me Odat Ekonomike të huaja kurdo që të aprovohet dhe se presin sygjerimet e tyre.

*Përgjigje për Hartim Gashin, PePeKo:* ju e dini që mbi bazën e kërkesave të kompanive, KIESA ka hartuar planin vjetor të punës. Në janar 2025 do të mbahet paniri në Suedi që është për sektorin e mobilerisë ndërsa për pjesën tjetër në Dubai ka qënë shumë i rëndësishëm këtë vit. Agjencia do të mundohet ta sigurojë një hapësirë në koordinim me z. Dalipi shkak i buxhetit.

**Arjeta Pozhegu, SHPKD**, shprehu shqetësimin për hendekun i cili krijohet nga sezona e panairëve që mbahen në muajin janar dhe shkurt, pastaj sezona e verës deri në shtator është pa aktivitete për sektorin e përpunimit të drurit. Tutje vazhdon duke kërkuar adresën për të kërkuar fonde, në mënyrë që të mbështeten prodhuesit vendor për këtë periudhë, meqë pagesa për pjesëmarrje në panairë bëhet në fund të vitit. Kjo do t’i ndihmonte që të mos shkëputen gjatë asaj periudhë deri sa të përpilohen dhe aprovohen strategjitë. Po ashtu shprehu shqetësimin lidhur me brendimin që e bën Kosovën të panjohur në Evropë për produktet e që prodhimet e saj nuk

identifikohen me një produkt të caktuar. Thekson se e shih Qeverinë si shtyllë kryesore për mbështetje në keto evente promovuese, takime B2B dhe misione tregtare.

**Ministre Rozeta Hajdari, MINT**, i përgjigjet znj. Arjeta Pozhegu: Ligji për Investime të Qëndrueshme na obligon që KIESA ta vazhdoj funksionimin e saj deri në hyrje në fuqi të të dy rregulloreve të agjencive të reja. Në këtë rast, KIESA po vazhdon funksionimin e saj me buxhetin dhe me planifikimin e panairëve. Janë 40 panairë për këtë vit dhe po bëhen rezervime të njëpasnjëshme. Të gjitha panairët e planifikuar do të zbatohen ose do të kryhen këto aktivitete në momentin kur dy rregulloret janë në fuqi. KIESA shuhet dhe dy agjencite e reja fillojnë funksionimin, ku në atë rast, ne, si agjenci e re për inovacion, ia kalojmë buxhetin ZKM-së për promovimin e eksporteve.

**Emrush Ujkani, EIC**, shprehu mirënjohje për bashkëpunimin me shefin e kabinetit të ZKM-së dhe për krijimin e dy agjencive.

Z. Ujkani ngriti pyetje mbi Atashetë Ekonomik që punojnë në kuadër të MPJD-së, duke theksuar se ministria ka një departament dhe staf që angazhohet në këto misione. Ai kërkoi sqarime se si do të sinkronizohen këto aktivitete, duke theksuar rëndësinë e një demokracie diplomatike dhe pyeti për misionin dhe funksionin e tyre.

**Luan Dalipi, Shef i Stafit, ZKM**, i përgjigjet z. Ujkanit duke i shpjeguar dallimin mes diplomacisë ekonomike dhe diplomacisë komerciale.

Natyrisht, ne bashkëpunojmë dhe do të vazhdojmë bashkëpunimin ngushtë me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe me të gjitha ministrinë sipas sektoreve që promovohen në kohë të caktuar gjatë vitit.

**Ministre Donika Gërvalla Schwarz, MPJD**, theksoi çështjen e Atasheve duke duke sqaruar se ata marrin status diplomatik dhe se ministria, në bashkëpunim me agjencitë e tjera, ua jep këtë status. Megjithatë, ka barriera teknike dhe administrative që e vështirësojnë këtë proces.

Po ashtu foli edhe për investimet e mërgatës dhe të diasporës. Vazhdoi duke theksuar se një pjesë e madhe e progresit ekonomik të fundit lidhet me bizneset aktive nga diaspora, të cilat kontribuojnë jo vetëm në ekonomi, por edhe në jetën e përgjithshme në Kosovë. Tutje theksoi se bizneset e suksesshme operojnë në një mjedis demokratik dhe dinë të menaxhojnë rreziqet dhe sfidat me të cilat përballet vendi.

Megjithatë, Kosova ende ka vështirësi në të qenit tërheqëse në tregun global ekonomik. Slogani "Jeto në Kosovë, dhe puno në Gjermani" është një fushë ku duhet investuar më shumë, duke promovuar idenë që kompanitë nga diaspora, aktive në sektorë si gastronomia, ndërtimi dhe teknologjisë informative, fushës së sigurimeve mund të rrisin punësimin dhe mirëqenien në Kosovë.

**Artan Mehmeti, Sekretariati, KKEI**, theksoi pikën e radhës në agjendë, atë të kyçjes në rrjet të energjisë. Vazhdoi duke theksuar ankesat e bizneseve lidhur me kostot shtesë për qasje adekuate në rrjet të energjisë elektrike, të cilat janë ngritur në forume të ndryshme sektoriale. Thutje theksoi dy lloje të ndryshme të kyçjes: 1) *kyçje në rrjet të shpërndarjes* dhe 2) *kyçje në rrjet të transmisionit*.

Bizneset që janë konsumatorë hasin vështirësi për kyçje në rrjetin e shpërndarjes. Shpesh, kapacitetet e kërkuara nuk janë të disponueshme dhe kompanitë duhet të presin investimet e KEDS-it, të cilat mund të jenë në plane afatgjata. Për këtë arsye, shumë kompani detyrohen të investojnë vetë, meqë nuk kanë kohë të presin.

**Ndërkaq, sa i përket kyçjes në rrjetin e transmisionit**, kompanitë që duan të prodhojnë energji ankohen se KOSTT-i nuk i trajton si të barabartë me Qeverinë.

Si rekomandime kryesore, edhe pse një listë më e gjerë rekomandimesh është përcjellë me raportin e punës së kësaj mbledhje, z. Mehmeti listoi këto në vijim:

- Informimi i bizneseve për pikat e mundshme të kyçjes në rrjet përmes një portali apo harte interaktive. Kjo për shkak se, shpesh, edhe pasi e përpilojnë planin e biznesit, nuk mund të kycen në rrjet të shpërndarjes, si pasojë e mungesës së informatave paraprake.
- Komunitat të paguajnë për trafot, stacionet apo linjat që lidhen me bizneset që kanë marrë leje ndërtimi.
- Rregullatori të pranojë investimet e kompanive që ndikojnë pozitivisht në ekonominë e vendit, apo t'i reflektojë investimet individuale në tarifë vetëm për kompanitë që i kanë bërë këto investime – për atë linjë ose stacion.

**Petrit Pepaj, ZRrE**, shprehu mirënjohje ndaj punës së Sekretariatit. Informoi se planet investive miratohen nga Rregullatori pas konsultimit publik dhe bazohen në strategjinë energjetike të miratuar nga Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës. Planet orientohen për investime në gjenerimin e energjisë elektrike, dhe planifikimi i tyre bëhet në bashkëpunim me komunitat. Në anën tjetër, Rregullatori ka zhvilluar një metodologji që udhëzon konsumatorët për lidhjen në rrjet.

Investitorët në zonat e planifikuara nuk paguajnë kosto lidhjeje, ndërsa në ato pa planifikim duhet të presin ose të financojnë vetë investimin. Problemet e ngritura në takimet e fundit do të adresohen në planin zhvillimor që do të diskutohet publikisht, përfshirë shqetësimet e anëtarëve të bizneseve.

ZRrE ka kërkuar që KEDS të publikojë profilin e ngarkesave, duke lehtësuar qasjen për investitorët që dëshirojnë të investojnë në zona të caktuara. Ky portal do të shërbejë si udhëzues, por ka nevojë për më shumë të dhëna.



Z. Pepaj prezantoi dy zgjidhje të propozuara: 1) që çdo konsumator të paguajë për investimet e reja, pavarësisht vendit të investimit; dhe 2) investitorët që zgjedhin zona të largëta, ku nuk ka rrjet të planifikuar, të investojnë vetë dhe të kompensohen nga konsumatorët e tjerë përmes pagesave të rrjetit. Propozojmë që konsumatori të paguajë sipas planifikimeve që bëhen në rrjetin e shpërndarjes duke pasur parasysh së paku tri elemente kyçe: eliminimin e rrezikut, cilësinë e shërbimeve dhe zgjerimin e infrastrukturës energjetike. Vlerësimi i investimeve (sipas kost-benefitit) do të bëhet duke u bazuar në përfitimet që konsumatorët në një zonë të caktuar do të kenë, dhe nëse këto vlerësohen me nota të larta, atëherë investimi do të fillojë automatikisht.

Po ashtu, janë zhvilluar biseda me Asociacionin e Komunave për të adresuar sfidat e shpronësimit.

**Artan Mehmeti, Sekretariati, KKEI**, pyet për mundësinë e ndryshimit të ligjit në të ardhmën në mënyrë që investitorët e huaj që duan të investojnë në mënyrë më të shpejtë në Kosovë, të kenë mundësi ta bëjnë këtë.

Meqë disa biznese i përcakton edhe rajoni, si p.sh. mbledhja e qumështit diku në një rajon dhe nuk ka qasje në atë rrjet, por ajo ka ndikim ekonomik për atë vend, a ka mundësi – edhe pse nuk është në plan – të shqyrtohet prej ZRrE-së që të kenë mundësinë të futen në investim të KEDS-it ose investimi i tij të pranohet ose të përfshihet në tarifë?

**Petrit Pepaj, ZRrE**, i përgjigjet pyetjes së z. Artan Mehmeti se, rregulloret zakonisht ndryshohen atëherë kur ka nevojë të arsyeshme dhe të domosdoshme. Ai thekson se investimi i fundit është bërë në rajonin e Malishevës. Është vendosur si prioritet për shkak se investimi në nivelin e tensionit 110 në stacion merr kohë të gjatë. KEDS është detyruar që ta bëjë një zgjidhje të përkohshme me një investim shumë të shpejtë me një linjë që po zbatohet për herë të parë në Kosovë që ajo linjë të përmbajë kapacitet 3-4 herë më shumë se sa linjat ekzistuese që janë, derisa të krijohet zgjidhja infrastrukturore në nivelin e transmisionit.

Investimet me interes kombëtar do vendosen në plane zhvillimore, mirëpo është me rëndësi të theksohet se çdo investim në gjenerim të energjisë elektrike, kostoja e investimit është në tarifën e tij. Do të thotë edhe tani që është bërë çmimi maksimal për energjinë solare edhe për energjinë me erë, është kalkuluar saktësisht edhe kostoja e investimit që i kushton atij investitori për një periudhë të caktuar dhe kohën se kur do ta kthejë ai investim në çmimin që do ta shesë te konsumatorët e vendit tonë.

**Hartim Gashi, PePeKo**, shprehu shqetësimin e tij lidhur me qasjen në rrjet të energjisë elektrike që kanë bizneset bujqësore kryesisht në zonat rurale. Për këtë arsye, si shoqatë së bashku me një projekt të USAID kanë propozuar incentive në mënyrë që të nxisin investime në energji të ripërtrishme. Kërkesa e shoqatës së tyre është që të përjashtohen nga pagesa e TVSH-së që do të shërbente si lloj incentive në mënyrë që të nxisin bizneset që të investojnë në panele solare. Pyetja

e tij konkrete është: kush mund t'i ndihmojë ata në këtë drejtim? A duhet ta adresojnë çështjen tek Ministria e Financave, tek ZRrE apo të parashtrajnë kërkesë së bashku me ministrin Faton Peci i cili është përkrahesi i madh në kauzat e tyre si industri.

**Z. Besnik Bislimi, Zevendeskrjeminstër i Pare**, së pari theksoi se shteti ndërton politika fiskale për qytetarët e vendit dhe jo për grupe të caktuar biznesi. Tutje foli për rëndësinë e qëndrueshmërisë, jo vetëm politike, por edhe fiskale për komunitetin e biznesit. Qeveria duhet të hartojë politika tatimore stabile dhe të trajtojë problemet me instrumente të tjera për cka duhet vlerësuar. Ai përmendi strategjitë dhjetëvjeçare për energjinë, ku parashikohet ngarkimi i pikave të transmisionit dhe planifikimi i investimeve. Qeveria nuk është kundër alokimit të fondeve për investime, përsa kohë ato përputhen me prioritetet e Qeverisë. Nëse Qeveria e sheh sektorin e IT-së si prioritet, mund të bëhen investime në këtë sektor, duke siguruar mbështetje pa ngarkuar konsumatorët. Tutje, i propozoi Sekretariatit t'i validojë dhe t'i filtrojë edhe më shumë rekomandimet para se t'i prezantojë para Këshillit.

**Artan Mehmeti, Sekretariati, KKEI**, theksoi se Sekretariati e ka vlerësuar të nevojshme të diskutohet çështja e prodhimit të energjisë, dhe faktit që duhet pritur për përgjigje nga Ministria. Një gjë e tillë shpesh mund ta pengojë investimin. Ai pyeti nëse mund të bëhen përjashtime për projekte me ndikim të madh në ekonomi dhe nëse rregullat mund të ndryshohen për një periudhë të gjatë. Z. Mehmeti shpjegoi se ndjenja e padrejtësisë është e pranishme tek bizneset, të cilat kontribuojnë në rrjet, por nuk ndihen të mbështetura. Ai sugjeroi që të ketë transparencë në pikat e kyçes përmes një portali, duke u dhënë bizneseve mundësinë të planifikojnë investimet e tyre. Për më tepër, përmendi taksat infrastrukturore që paguajnë bizneset, por që shpesh nuk përfshijnë infrastrukturën energjetike. Ai sugjeroi që nëse një komunë jep leje dhe kompania paguan taksën, duhet të kërkohet gjithashtu që komuna të mbulojë shpenzimet për infrastrukturën energjetike.

**Luan Dalipi, Shef i Stafit, ZKM**, kërkoi që kërkesat të validohen nga institucionet përkatëse publike, duke theksuar rëndësinë e angazhimit të Qeverisë për të planifikuar veprimet dhe për të përcaktuar përgjegjësitë për çdo problem dhe sfidë.

*Strategjia e Zhvillimit*, theksoi rëndësinë e strategjisë së zhvillimit, duke përmendur që zonat ekonomike dhe parqet industriale duhet të planifikohen në lidhje me rrjetin e transmetimit. Idetë janë që të caktohen lokacione potenciale për zhvillimin e parqeve industriale, në mënyrë që bizneset të mos vendosin individualisht. Disa institucione ndërkombëtare financiare, si IFC dhe BERZH, kanë ofruar ndihmë në planifikim për krijimin e eko-parqeve industriale, për të lehtësuar barrën e taksës mbi karbonin për eksportet.

**Ministër Faton Peci, MBPZHR**, u ndërlidh me temën e energjisë së ripërtrishme duke thënë se energjia e ripërtrishme si investim në ferma, është kryesisht investim i Ministrisë së Bujqësisë por

edhe incentivë private. Si ministri, i jemi drejtuar ZRRE-se para një viti, për shkak se një sasi e konsiderueshme e energjisë se ripërtrishme që prodhohet në faza të caktuara humbet dhe nuk është pjesë e rrjetit. Prej ZRRE-së kërkojmë që të shihet modaliteti që sasia e prodhuar e energjisë elektrike tek keto ferma të mos humbet, e aq më tepër që në kohën e qeverisjes tonë ne jemi përballur me një krizë të përgjithshme në sektorin e energjisë.

Në parim, pajtohem me zëvendëskryeministrin se shteti i vendos rregullat, ka norma tatimore, por megjithatë mendoj që në zona shumë të thella ku vlerësohet që efekti multiplikativ edhe mundësia e investimit të ngjallet në zonat e caktuara besoj se mund të gjindet ndonjë modalitet. Në vendet e Bashkimit Evropian është vlerë e qeverisjes zhvillimi i balancuar edhe në mes rajoneve. Prandaj, në prizmin e aspektit të qeverisjes të një zhvillimi të balancuar për zonat më të prapambetura mund të gjindet ndonjë zgjidhje - juristët thonë “modus vivendi”.

**Zëvendësministër Getoar Mjeku, ME,** shprehu mbështetje për komentet e zëvendëskryeministrit mbi nevojën për intervenim të Qeverisë në ndihmën për investimet e bizneseve. U theksua rëndësia e barazpeshës së kërkesave me interesat shtetërore për të stimuluar sektorët prioritar dhe objektivat e elaboruara në Ligjin për Investime të Qëndrueshme.

Sa i përket financimit, duhen shqyrtuar burimet e mundshme për këto shpenzime, duke u kujdesur për të hyrat. Ndërsa disa biznese vazhdojnë të përfitojnë mbështetje institucionale, është e rëndësishme të ruhet një çmim energjisë i përballueshëm. Gjithashtu, synohet integrimi i 1600 MW energji nga burime të rinovueshme deri në vitin 2031, duke theksuar nevojën për projekte strategjike në bashkëpunim me sektorin privat. Energjia duhet parë si mjet për zhvillim, jo si qëllim në vetvete.

**Arian Zeka, Drejtori Ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane (AmCham),** prezantoi propozimin e AmCham-it me titull “Përshpejtimi i Rritjes Ekonomike përmes Përkrahjes së Synuar Financiare,” i cili synon të avancojë zhvillimin ekonomik në Kosovës përmes mbështetjes së targetuar.

Ai theksoi se ky propozim është ndërtuar mbi metodologjinë e “benchmarking-ut strategjik”, që nënkupton krahasimin e performancës ekonomike të Kosovës me shtetet që konsiderohen lidere. Kjo qasje ka për qëllim të mësojmë nga praktikat më të mira globale, për këtë arsye, për referencë janë marrë shtete si Izraeli, Estonia, Zelanda e Re, Mbretëria e Bashkuar dhe Singapori. Duke analizuar performancën e tyre gjatë viteve, kemi arritur të kuptojmë dhe identifikojmë faktorët që kontribuojnë në suksesin e tyre. Disa nga propozimet e përfshira mund të lidhen me Fondin e Inovacionit, të cilin e përmendi z. Dedaj, si dhe me skemat ekzistuese të granteve, duke përfshirë ato të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, që kanë për qëllim standardizimin – një nga sfidat kryesore për të arritur ndikimin që synojmë.

Shtoi tutje, se pako e propozuar arrin vlerën prej 120 milionë Euro nga të cilat 30 milionë euro janë paraparë për të promovuar eksportin e shërbimeve, 20 milionë euro për rritjen e eksportit të mallrave, 30 milionë euro për përkrahjen e startup-eve dhe 40 milionë euro për digjitalizim.

Z. Zeka prezantoi detajet e pakos për përkrahjen e bizneseve, të propozuara si në vijim:

1. **Fondi për nxitjen e eksportit të shërbimeve** - 30 milionë euro për të mbështetur IT-në, shërbimet e biznesit dhe sektorët me vlerë të lartë.

- Ndihmë direkte për kompanitë që operojnë në tregje të huaja.
- Grante për zgjerimin e tregjeve, certifikime, pjesëmarrje në panaire ndërkombëtare dhe marketing jashtë vendit.
- Stimuj për punësimin e talentëve përmes subvencionimit të pagave për punonjës të rinj të përfshirë në këtë proces.

Ndikimi i pritur nga ky program:

- Rritje prej 20% në afat të shkurtër, me të ardhura shtesë prej 100 milionë euro në dy vite.
- Rritje eksportit të shërbimeve me 150% deri në vitin 2028, me TI-në që kontribuon 1.1 miliardë euro.
- 30,000 vende të reja pune dhe 1.5 miliardë euro shtesë në BPV deri në vitin 2035.

2. **Fondi për nxitjen e eksportin e mallrave** - 20 milionë euro për produktet bujqësore, tekstilet dhe mallrat e përpunuara.

- Mbështetje financiare për eksportuesit e mallrave.
- Lehtësim i logjistikës dhe tregtisë, ulje e kostove të transportit dhe magazinimit.
- Përmirësim i cilësisë së produkteve për t'iu përshtatur standardeve ndërkombëtare.

Ndikimi i pritur nga ky program:

- Rritje prej 10% në afat të shkurtër, duke kontribuar 200 milionë euro në ekonomi në dy vite.
- Dyfishim i eksporteve deri në vitin 2028, me shtesë prej 1 miliard euro.
- 15,000 vende të reja pune dhe 1.3 miliardë euro në BPV deri në vitin 2035.

3. **Fondi për përkrahjen e startup-eve** - 30 milionë euro për zhvillimin e startup-eve në teknologji, inovacion dhe shërbime të biznesit.

- Përkrahje për financim fillestar, grante, inkubatorë dhe përsheptues për mentorim, dhe burime për trajnim.

- Stimuj tatimorë për pesë vitet e para të funksionimit.

Ndikimi i pritur nga ky program:

- 100 milionë euro të ardhura dhe 2,000 vende pune brenda dy viteve.
- Afat i mesëm (2030): 50% rritje në numrin e startup-eve, 300 milionë euro kontribut në ekonomi dhe 10,000 vende pune.
- Në afat të gjatë, Kosova mund të zhvillojë një ekosistem të fuqishëm të startup-eve me vlerë mbi 1 miliard euro, duke tërhequr investitorë të huaj dhe duke u pozicionuar si një qendër për inovacion në Evropën Juglindore.

**4. Fondi për digjitalizimin e sektorit privat** - 40 milionë euro për përsheptimin e transformimit digjital të kompanive.

- Grante për transformim digjital, trajnime për punonjësit dhe subvencione për shërbimet Cloud dhe ruajtjen e të dhënave.

Ndikimi i pritur nga ky program:

- 500 kompani të digjitalizohen, 10% rritje produktiviteti dhe 20 milionë euro kursime në kosto operative në afat të shkurër.
- 500 milionë euro në BPV dhe 5,000 vende pune të reja deri në 2030.
- Industritë e digjitalizuara pritet të shtojnë 1 miliard euro në ekonominë e Kosovës deri në vitin 2040, duke kontribuar në një model ekonomik të qëndrueshëm dhe të drejtuar nga teknologjia.

**Nora Hasani, OEGJK**, falenderoi zëvendëskryeministrin z. Bislimi për pritjen e një delegacioni të madh të kompanive gjermane së bashku me OEGJK-në. Përmendi organizimin e Forumit Ekonomik nga OEGJK, duke e falenderuar për mbeshtetje z. Bislimin edhe në vitin 2022. Znj. Hasani përmendi gjithashtu se një nga temat kryesore të diskutimit ishin vështirësitë gjeopolitike, duke përfshirë edhe procesin e Berlinit, të cilin e cilësoi të rëndësishëm për kompanitë gjermane të interesuara për investime në Kosovë. Ajo shtoi pyetje lidhur me qëndrimin e Qeverisë së Kosovës dhe zhvillimet e ardhshme, me fokus të veçantë në Samitin e ardhshëm që do të mbahet në Berlin.

**Kryeministri Albin Kurti, Kryesues, KKEI**, theksoi se nesër do të mbahet mbledhja e CEFTA-s, dhe pas saj do të ketë më shumë informacion për Samitin e Procesit të Berlinit që do të zhvillohet javën e ardhshme. Ai shprehu optimizëm për rrugën e Qeverisë, edhe pse ende nuk janë siguruar skanerët e premtuar si donacion, as ato që Qeveria kishte ndërmend të blinte.

Një pikë kufitare do të hapet në Merdare, me kontroll të shtuar në vendkalim, duke u ndodhur vetëm 300 metra larg Terminalit Doganor. Z. Kurti përmendi se ka parë skanerët 2D dhe 3D në Hamburg, duke theksuar se skanerët statik janë më efikasë se ata mobil, por që janë ndërtesa të sofistikuar për cka Kosova nuk do të mund t'i ndërtoj shkaku i çmimit dhe kohëzgjatjes së ndërtimit. Z. Kurti tutuje vazhdon duke thene: kur hyn të themi kamionet me grurë apo misër, shumë lehtë mund të kuptohet nëse brenda ka armatim apo municion, por kur ka produkte të gatshme nëpër kuti atëherë është shumë vështirë që të hapen të gjitha për të parë se çfarë ka brenda. Ai theksoi rëndësinë e masave të sigurisë për të kontrolluar mallrat, duke siguruar që këto masa nuk janë tregtare, por të nevojshme për siguri.

Ai shtoi se në këto dy vite të fundit kemi konfiskuar sasi enorme të armatimit të cilët në Veri të Kosovës janë sjellur për një konflikt të gjërë dhe të gjatë i cili nuk ka ndodhur për shkak të vendime të duhura, dhe profesionalizmit dhe integritetit të policisë.

**Z. Besnik Bislimi, Zëvendëskryeministër i Parë, nderlidhet ne bisedë:**

*Lidhur me masën e sigurisë ndaj mallrave serbe:* Masa e sigurisë është vetëm masë e sigurisë dhe jo masë tregtare, për cka edhe protokollat e CEFTA-s lejojnë që në raste të kërcenimi të sigurisë të mund të suspendohen edhe rregullat e tregtisë së lirë. Z. Bislimi tutje theksoi se Kosova në vazhdimësi ka qënë e gatshme që të ketë lëvizje të lirë të mallrave dhe të kapitalit më të gjitha vendet fqinje, sepse Kosova beson se kjo është rruga më e mirë për rritjen e kapaciteteve prodhuese të bizneseve, por edhe mireqenien e qytetareve. Për aq kohe sa rreziku i sigurisë ekziston, do të kete masa të shtuara të sigurisë në kalimin e mallrave që vien nga Serbia.

Tutje, z. Bislimi përmendi një rast ku një kompani hungareze përpiqej të blinte një prodhues spanjoll trenash, por Qeveria spanjolle vendosi veto, duke e pamundësuar transaksionin. Pavarësisht padisë në Komisionin Evropian, Gjykata e KE-së theksoi se çështjet e sigurisë kanë përparësi mbi liritë e tregtisë dhe kapitalit, duke mbështetur veprimin e Spanjës. Vetoja u justifikua për shkak se një nga aksionarët e kompanisë hungareze kishte origjinë ruse, gjë që alarmoi një vend anëtar të BE-së. Kjo tregon se Kosova ka të drejtë të kujdeset për sigurinë e saj. Në të njëjtën kohë, Bislimi theksoi rëndësinë e heqjes së ndikimit të UNMIK-ut nga vendimmarrjet dhe pjesëmarrja në forumet e CEFTA-së në mbledhjen e ardhshme në Beograd.

*Lidhur me prezantimin e z. Arian Zeka (AmCham):* Qeveria ka treguar në vazhdimësi gadishmëri që seriozisht ta trajtojë rritjen e mëtejme të mbështetjes për biznese e sidomos të adresoj ato biznese që kanë potencial për eksport ose për zhvillim të sektoreve strategjik. Natyrisht duke i kushtuar rëndësi atyre bizneseve që kanë potencial për rritje të eskporteve. Por, nevojitet që bashkarisht ta përpiqim një program me kriteret të sakta, në mënyrë që ato shifra të materializohen. Mbështetja të nderlidhet me materializim të pritjeve me analizën e Qeverisë pastaj.

*Koment për Nora Hasani, OEGJK: Qeveria në vazhdimësi ka treguar se është partner serioz i secilës Odë Ekonomike e cila mbështet interesin e ekonomisë dhe të bizneseve.*

**Ministre Donika Gërvalla Schwarz, MPJD**, e shfrytëzoi mundësinë për të adresuar disa komente lidhur me barrierat e quajtura si ekonomike, nga përfaqësues të shoqatave të bizneseve. Ajo sqaroi se në këtë proces nuk ka pasur barriera ekonomike, ka qenë një proces i thjeshtë i sigurisë. Për këtë arsye, ajo sugjeroi që deklaratat mbi këto barriera, të reflektojnë realitetin e operimit në Kosovë.

Gjithashtu, ajo përmendi shembuj nga vende si Holanda dhe Polonia, që zbatojnë masa kontrolli për menaxhimin e migracionit, duke theksuar se shtetet janë sovranë dhe kanë të drejtë të vendosin masat e tyre të sigurisë. Ajo gjithashtu ngriti çështjen e përfaqësimit të Kosovës në CEFTA përmes UNMIK-ut dhe ftoi për diskutime të hapura për të parë nëse kjo është e drejtë, duke nënvizuar rëndësinë e shmangies së dezinformatave që mund të dëmtojnë proceset.

**Emrush Ujkani, EIC**, shprehu mirënjohje për bashkëpunimin e shkëlqyer me ZKM-në për kauzat e përbashkëta. Theksoi interesin për një diskutim më të thellë mbi Planin e Rritjes dhe çështje të tjera të ngritura nga shoqatat gjatë këtij takimi të Këshillit.

Vërejtja e zëvendëskryeminstres Gërvalla-Schwarz ishte e saktë, duke theksuar se traktatet themeluese të BE-së lejojnë mbrojtjen në rast se cenohet shëndeti publik dhe siguria e një vendi.

**Z. Besnik Bislimi, Zëvendëskryeminstër i Parë**, theksoi se Qeveria ka miratuar Planin e Rritjes dhe se të premtën përfunduan diskutimet brenda KE-së për pesë agjendat e reformave që do të ecin përpara, përfshirë ato të Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut, Shqipërisë, Kosovës dhe Serbisë. Bosnja nuk ka arritur të depozitojë planin e saj.

Pika më e rëndësishme është krijimi i një plani të qartë për komunikimin publik mbi përmbajtjen e Planit të Rritjes dhe mënyrat se si aktorët e ndryshëm mund të ndihmojnë në realizimin e objektivave të reformave që ka ndërmarrë Qeveria, si dhe si kjo do të përkthehet në investime infrastrukturore. Pasi plani të aprovohet nga Qeveria, do të organizohet një takim për të ndarë informacionin me rrjetin e odave ekonomike.

**Artan Mehmeti, Sekretariati, KKEI**, përmendi pikën e rradhës të agjendës e cila është miratimi i Rregullave të Punës së KKEI-së.

**Ministre Rozeta Hajdari, MINT**, ngriti si çështje Rregulloren e Punës dhe Procedurave të Sekretariati të KKEI-së meqë kjo Rregullore parashih Sekretariatin si të pavarur. Ajo shtoi se ekziston Ligji për Administratën Shtetërore dhe Agjencitë e Pavaruar që janë vartëse qoftë të Parlamentit apo të ZKM-së, njëlloj si vetë MINT, që i përgjigjen ZKM-së. Vazhdoi tutje duke propozuar që të mirren parasysht të gjitha ligjet në fuqi siç janë Ligji për Administratën Shtetërore,

Rregullovoja e Qeverisë për Punën e ZKM-së dhe përgjegjesive të ministrive dhe pastaj Sekretariati të gjej veten.

**Artan Mehmeti, Sekretariati, KKEI**, kërkoi nga ministrja Hajdari që të theksojë nenin që mendon se duhet të ndërrohet meqë kjo rregullore është më tepër për punën e Sekretariatit.

**Ministre Rozeta Hajdari, MINT**, ofroi ndihmën e MINT për të konsoliduar këtë Rregullore, në mënyrë që të zgjerohet fushëveprimi i Sekretariatit dhe jo siç është tani në nivelin e ngushtë të klimës së të bërit biznes, sepse ka edhe shumë fusha të tjera të nivelit kombëtar. Tutje shtoi se ndryshimet e bëra nga MINT do të dërgohen me track changes për të propozuar se si duhet të funksionoj ky Këshill. Po ashtu theksoi se ekziston edhe një Këshill për Industri që është i krijuar me vendim të Qeverisë për cka organizon takime katër herë në vit. Në këtë mënyrë do të plotësohen me Këshillet e ndryshme në nivel sektorial të industrisë, atë Kombëtar të Këshillit për Ekonomi dhe Investime dhe pastaj hidhet në diskutim dhe votohet.

**Artan Mehmeti, Sekretariati, KKEI**, shprehu gadishmerinë për bashkëpunim me MINT për ndryshimet që do t'i propozojnë lidhur me Rregullorën e Punës dhe Procedurave të Sekretariati të KKEI-së. Po ashtu theksoi se kjo Rregullore mund të votohet edhe online, dhe nëse nuk ka votë kundër atëherë mund të konsiderohet si e miratuar.

**Ministre Rozeta Hajdari, MINT**, theksoi se do të propozojë ndryshime në Rregulloren e KKEI-së gjatë fundjavës dhe do ta përcjellë tek Sekretariati javën në vazhdim.

**Endrita Xhaferaj, EBRD**, falenderoi të pranishmit. Ofroi shpjegim për krijimin e Sekretariatit duke theksuar se kriteri bazë ka qënë për ta bërë të pavarur, që nuk e përbën as pjesë të Qeverisë e as të ndonjë dhome, sepse kështu janë dakorduar me ZKM-në. Tutje shtoi se është i përbërë nga profesionist të fushave përkatëse të dedikuar vetëm për filtrimin e çështjeve që vjen nga sektori privat që pastaj përpilohen analiza analitike dhe ofrohet në formë rekomandimesh për organet e Qeverisë. Ky dialog funksion dhe momentin kur trupëzohet brenda Qeverisë, atëherë mund të flitet për varësi dhe strukturën sipas ligjeve se si duhet të trajtohet.

**Arian Zeka, Oda Ekonomike Amerikane (AmCham)**, reagoi lidhur me komentin e ministres Gërvalla-Schwarz për sigurinë e mallrave serbe duke theksuar se ministrja nuk mund t'ua imponojë odave ekonomike se si duhet të prononcohen në media. Shtoi se deklarata e tillë nuk duhet të vijë nga një zyrtarë e lartë e Qeverisë, sepse e cenon funksionimin demokratik të shoqërisë kosovare dhe dëmton frymën e këtij Këshilli Kombëtar të Ekonomisë dhe Investimeve. Z. Zeka insistoi që ky reagim i tij, të përfshihet në procesverbal.

**Z. Besnik Bislimi, Zëvendëskryeministër i Parë**, në mungesë në ministres Gërvalla, reagoi ndaj komentit të z. Zeka duke thënë se, nuk e ka parë si ndonjë tendencë për formulim të prononcimit reagimin e zj. Gërvalla-Schwarz. Tutje shtoi, se si shtet ende nuk kemi arritur në atë nivel që



MPB-së t'i alokojmë përgjegjësi për të vendosur barriera tregtare e as ekonomike. Duke e sqaruar më tej reagimin e ministres Gërvalla, ai tha se masa në fjalë është brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme, e kësaj ministrie nuk mund t'i atribuohet asnjë masë ekonomike. Pra, Ministria nuk i është drejtuar personave specifik, por shprehu një brengë për energjinë negative që mund të krijohet brenda shtetit për procese shumë të rëndësishme dhe politike.

**Artan Mehmeti, Sekretariati, KKEI**, falenderoi pjesëmarrësit për kontributin dhe i ftoi të përgatiten për takimin e radhës të KKEI. Meqenëse në diskutimin e sotëm nuk arritëm të aprovojmë Rregullat dhe Procedurat e punës së KKEI, të njëjtat do të shohim t'i aprovojmë në mënyrë elektronike pas pranimit të rekomandimeve nga MINT.

**Angazhimi i Sekretariatit të KKEI deri në takimin e radhës:**

- Vlerësimi i çështjeve të ngritura nga sektori privat, në përputhje me metodologjinë e punës;
- Validimi i çështjeve me institucionet publike, duke u përpjekur që të caktohen hapat dhe afatet për secilën kërkesë apo rekomandim.

## LISTA E PJESËMARRËSVE

### Përfaqësuesit nga institucionet publike:

1. Kryeministri, kryesues;
2. Zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog;
3. Ministria e Punëve të Jashtme dhe të Diasporës;
4. Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
5. Zëvendësministri i Ekonomisë;
6. Zëvendësministri i Financave, Punës dhe Transfereve;
7. Zëvendësministri i Administrimit të Pushtetit Lokal;
8. Shefi i Stafit të Kryeministrit;
9. Zëvendësministër i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
10. Përfaqësues i Bankës Qëndrore të Kosovës;
11. Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës;
12. Drejtori i Përgjithshëm i Doganës të Kosovës;
13. U.D. Drejtor i Përgjithshëm i KIESA;

### Përfaqësuesit nga odat dhe shoqatat e bizneseve:

14. Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës;
15. Drejtorja Ekzekutive e Odës Ekonomike Gjermano – Kosovare;
16. Drejtori Ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikano – Kosovare;
17. Drejtori Ekzekutiv i Këshillit të Investitorëve Evropian;
18. Drejtorja Ekzekutive e Shoqatës së Përpunuesve të Drurit të Kosovës (SHPDK);
19. Drejtorja Ekzekutive e Asociacionit të Kosovës për Teknologji të Informacionit dhe Komunikimit (STIKK);
20. Drejtori Ekzekutiv i Kllasterit të Industrisë së Metalit dhe Energjisë së Ripërtërishme në Kosovë (KIMERK);
21. Drejtori Ekzekutiv i Shoqatës për përpunimin e Pemëve dhe Perimeve të Kosovës (PePeKo);
22. Drejtore e Kllasterit të Ndërtimeve të Parafabrikuara të Kosovës (PREFAB);
23. Kryetarja e Forumit Ekonomik të Gruas;

### Përfaqësuesit nga Ambasadat dhe misionet diplomatike:

24. Përfaqësues nga Ambasada Amerikane;
25. Përfaqësues nga Ambasada e Italisë;
26. Përfaqësues nga Ambasada e Holandës;
27. Përfaqësues nga Ambasada e Austrisë;
28. Përfaqësues nga Ambasada e Izraelit;
29. Përfaqësues nga Ambasada e Zvicrës

30. Përfaqësues nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë;

Përfaqësuesit nga partnerët ndërkombëtarë:

- 31. Drejtori i Zyrës së Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim në Kosovë (BERZH);
- 32. Drejtori i Sekretariatit të shtetit zviceran për çështje ekonomike (SECO);
- 33. Përfaqësues nga Banka Botërore në Kosovë (BB);
- 34. Udhëheqësi i programit të Agjencisë së SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID);
- 35. Udhëheqës i Zyrës së Korporatës Ndërkombëtare Financiare në Kosovë (IFC);
- 36. Udhëheqës i Zyrës së Fondit Monetar Ndërkombëtar (IMF);

Pjesëmarrës të tjerë:

- 37. Drejtori Ekzekutiv i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë;
- 38. Përfaqësues shtesë nga BERZH;
- 39. Përfaqësues shtesë nga ZKM;
- 40. Përfaqësues shtesë nga OEK;

SHKURTESAT E PËRDORURA

KKEI – Këshilli Kombëtar për Ekonomi dhe Investime

OEK – Oda Ekonomike e Kosovës

OEGJK – Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare

AmCham – Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë

STIKK - Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit të Kosovës

SHPDK – Shoqata e Përpunuesve të Drurit të Kosovës

ZKM – Zyra e Kryeministrit

ZPS – Zyra për Planifikim Strategjik

ZRrE – Zyra e Rregullatorit të Energjisë

MPB – Ministria e Punëve të Brendshme

MINT – Ministria e Industrisë dhe Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

MBPZHR – Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

BQK – Banka Qëndrore e Kosovës

ATK – Administrata Tatimore e Kosovës

DK – Dogana e Kosovës

EFTA – Shoqata e Tregtisë së Lirë Evropiane

CEFTA - Marrëveshja e Evropës Qëndore për Tregti të Lirë

BE – Bashkimi Evropian

KE - Komisioni Evropian

BPV – Bruto Produkti Vendor